

VENDIM
Nr. 12, datë 21.5.2014

PËR RINOVIM LICENCE SHA UJËSJELLËS PATOS

Në mbështetje të nenit 14, pika 1/a, nenit 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujësive të ndotura”, si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë”, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Rinovim licence për efekt të përfundimit të afatit sh.a. Ujësjiellës Patos me:
Drejtues ligjor Petrit Elmazaj
Drejtues teknik Veiz Xhelilaj
2. Operatori sh.a. Ujësjiellës Patos autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategoritë:
Kategoria A Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik.
3. Zonat e shërbimit të këtij operatori janë: bashkia Patos; komunat Portëz, Cakran.
4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare, deri në datën 20.5.2018.

KRYETARI
Avni Dervishi